

PAKR.nr.595/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.P. nga Prishtina, për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 pika 1.1 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, dhe mbrojtëses së të akuzuarit av. L.J., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.128/2018 të datës 12.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 25.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, dhe e mbrojtëses së të akuzuarit L.P. ,ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.128/2018 të datës 12.10.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.128/2018 të datës 12.10.2018, i akuzuari L.P., është shpallur fajtor për veprat penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 pika 1.1 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale është gjykuar, dhe atë; për veprën e parë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet, kurse për veprën e dytë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, ndërsa me aplikimin e dispozitave të parapara për shqiptimin e dënimit për veprat penale në bashkim, bazuar në dispozitat e nenit

80 të KPK-së, i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.12.2017, e tutje.

Ndaj të akuzuarit po ashtu, është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ashtu që të njëjtit i është konfiskuar thika e markës, "Stainless", e precizuar më detajisht si në vërtetimin për marrjen e sendeve 2017-AB-3833 të dt. 11.12.2017, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Me aktgjykimin e ankimuar i akuzuari është liruar nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të njëjtat – pra, shpenzimet e procedura penale kanë mbetur barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari I.P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në procedurë kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore – DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që të ndryshohet, aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.P., av. L.J., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën i ka njoftuar Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarit, përfaqësuesin e autorizuar të palës së dëmtuar, të akuzuarin L.P. dhe mbrojtësen e tij av. L.J.. Në seancën e kolegjit prezantoi përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. I.R., të dëmtuarit-prindërit e tani të ndjerit SH.P., i akuzuari L.P. P. dhe mbrojtësja e tij av. L.J., ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullte nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit, për çka, gjykata seancën e kolegjit e mbajti në mungesë të palëve të ftuara me rregull, konform dispozitave të nenit 390 par.4 të KPPK-së. Në seancën e kolegjit, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar deklaroi se e përkrah ankesën e prokurorisë, duke ngelur pranë pretendimeve si në ankesë, të cilën e përkrahu edhe i dëmtuari I.P., ndërsa, mbrojtësja e të akuzuarit L.P., av. L.J., pasi më parë elaboroi shkurtimisht përmbajtjen e ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë, e njëjta ngeli në tërësi pranë pretendimeve si në ankesë, të cilën e përkrahu edhe i akuzuari i cili ishte prezent në seancën e kolegjit.

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës me shkrim PPA-I.nr.564/18, të datës 28.12.2018, i ka propozuar gjykatës që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar, ashtu që, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i

shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa, ankesa e mbrojtëses të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesa, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Me ankesat e palëve edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase, as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të prokurorisë si dhe ato të mbrojtëses së të akuzuarit, nuk janë të bazuara.

Në ankesën e prokurorisë, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se me rastin e caktimit të dënimit, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar konformë kufijve të paraparë për caktimin e dënimit, ngase, në rastin konkret, ka bërë përshkrimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, mirëpo, nuk e ka bërë vlerësimin real të tyre, ngase rrethanat lehtësuese i ka mbiçmuar, ndërsa, ato rënduese nuk i ka vlerësuar në mënyrë adekuate, ngase, vetëm ka bërë numërimin e rrethanave lehtësuese duke potencuar se në kuadër të tyre, sidomos: pranimin e fajësisë dhe atë për dy vepra penale, pendimin e shprehur për kryerjen e veprës penale, kërkim falja nga të dëmtuarit dhe shprehja e keqardhjes, moshën e të dëmtuarit-viktimës, pastaj, faktin se i akuzuari me tani të ndjerin ishin shokë, se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, pastaj, në kuadër të rrethanave rënduese, duke numëruar si rrethana rënduese, faktin se gjatë kryerjes së veprës penale i akuzuari ka treguar këmbëngulësinë, pastaj, vendi i kryerjes-ku vrasjen e ka kryer tek shtëpia e dajës së tani të ndjerit dhe atë pasi më parë ishin rrahur në mes veti, rrethana këto, pra, të gjitha lehtësuese dhe rënduese, që drejtë janë konstatuar por nuk janë vlerësuar realisht konform dispozitave të nenit 73 të KPPK-së, pastaj, po ashtu, ka edhe rrethana tjera që nuk janë marrë parasysh, si mënyra e kryerjes së veprës penale, ku tani të ndjerin e ka goditur me paramendim dhe atë katër herë radhazi, pastaj, faktin se i ndjeri ishte i moshës 17 vjeçare, rrethana këto të gjitha të cilat sikur të merreshin parasysh, atëherë është dashur që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më të ashpër

me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Ndërkaq, në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit theksohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar realisht e as në masë të duhur, sidomos në rastin konkret nuk ka zbatuar dispozitat për zbutje të dënimit të parapara nga neni 73, 75 dhe 76 të KPK-së, për çka, sidomos është dashur të merren parasysh rrethanat se i akuzuari, ka pranuar fajësinë qysh në seancën e shqyrtimit fillestar dhe i njëjti ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me organet e drejtësisë, i ka kërkuar falje familjes së viktimës, duke shprehur kështu pendim të thellë, por, duke marrë parasysh edhe praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë, për këtë lloj të veprave penale, atëherë, janë të gjitha këto rrethana të cilat kushtëzojnë domosdo shqiptimin e një dënimi shumë më të butë me burgim se sa dënimi i shqiptuar me aktgjykimi e ankimuar.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të lartë cekura, të prokurorisë për shqiptimin e dënimit më të ashpër, gjegjësisht, të mbrojtëses së të akuzuarit për shqiptim të dënimit më të butë nuk qëndrojnë, ngase, në ankesat e paraqitura nuk prezantohet ndonjë rrethanë tjetër rënduese apo lehtësuese të cilat kishin me pasur ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e dënimit, për çka kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, drejt dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK, ngase në rastin konkret edhe rrethanat lehtësuese të vlerësuara, për të akuzuarin L.P., se i njëjti ka pranuar fajësinë për dy vepra penale, është penduar, me tani të ndjerin kanë qenë shokë, i ka kërkuar falje familjes së viktimës, moshja e tij e re, pastaj, faktin se nuk është i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, kurse si rrethana rënduese ka marrë këmbëngulësinë për kryerjen e veprës penale si dhe faktin se i akuzuari ka shkuar tek shtëpia e dajës së tani të ndjerit dhe ka kryer veprën penale dhe atë pasi më parë ishte rrahur me tani të ndjerin, janë të pranueshme për këtë gjykatë, kështu që rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cekura në ankesa, shumicën prej tyre i ka pasur parasysh edhe gjykata e shkallës së parë, ndërsa, disa nga ato rënduese që cekë prokuroria janë po ashtu edhe elemente të veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, kurse, disa nga rrethanat lehtësuese që cekën nga mbrojtësja e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysh, e disa të tjera nuk janë me ndikime të drejtë për drejtë që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim tjetër nga ai që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën si është zhvilluar ngjarja ditën kritike, pastaj shkaktimin e pasojës së ndaluar, e sidomos duke marrë parasysh faktin se menjëherë pas konfliktit fizik në mes tyre, i akuzuari shkon në shtëpinë e dajës së tani të ndjerit dhe e thërret tani të ndjerin, ku me të dalë nga shtëpia tani i ndjeri, i akuzuari e ka goditur me thikë dhe atë katër herë radhazi, pra, në mënyrë të papritur, gjë që, as që e ka prituri tani i ndjeri, atëherë, rezulton se dënimi i shqiptuar për të akuzuarin me aktgjykimin e ankimuar, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu i njëjti është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe asaj individuale dhe se me

dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.595/2018, më dt. 25.01.2019

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti